

Nr Prot: 3166

Durrës, më 26.10 . 2010

Ftesë për pjesmarrje

Autoriteti Portual Durrës fton publikun, në takimin e datës 17.11.2010 ora 11.00, që do të mbahet në Pallatin e Kulturës me temë “Rehabilitimi i Basenit dhe Kanalit hyrës të Portit nëpërmjet thellimit”.

Përshkrim i Shkurtër i Projektit

Thellimi është një veprimtari e domosdoshme “jetësore” e cila gjen aplikim në shumë porte të botë me qëllim mbajtjen dhe përmirësimin e thellësive të tyre te lundrueshme duke:

- Garantuar hyrje dhe manovrim më të sigurve të anijeve në port;
- Mundësuar konkurrencën e portit në raport me porte të tjera të rajonit.

Aktualisht, Porti i Durrësit përballlet me kufizime në thellësi. Për këtë arsye, u Autoriteti Portual Durrës vendosi për te ndërhyrë me qëllim që të mundësohet hyrja e anijeve me një madhësi afro 30,000 DWT (ngarkesa rinfuzë) ose 1,700 TEU (njësi kontejnerësh). Kjo ndërhyrje konsiston në Rehabilitimin e Portit nëpërmjet thellimit të kanalit hyrës dhe basenit e cila klasifikohet si një nga fushatat me te rëndësishme te mirëmbajtjes se portit.

Nga vetë natyra e saj, mirëmbajtja nëpërmjet thellimit ka potencial ndikimi në ekosistemin ujor, në veçanti nëse sedimentet përmbajnë ndotës.

APD kontraktoi firmën gjermane HPC Hamburg Port Consulting GmbH për hartimin e Raportit Mjedisor në zbatim të Ligjit Nr. 8990 (2003) “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.

Qëllimet kryesore të këtij Raporti Mjedisor janë:

- Të ndërhyjë që punimet që do të zhvillohen të jenë tërësisht në mbrojtje të mjedisit ujor dhe atij tokësor në afërsi;
- Të mbrojnë natyrën nëse do të vërehen ndikime të mundshme mjedisore si


rrjedhojë e punimeve të thellimit;

- Të hartojë një program menaxhimi/monitorimi mjedisor përkatës.

Raporti vlerësimit Mjedisor, bazon konkluzionet e tij mbi vëzhgimet e analizat e bëra ne terren në bashkëpunim me përfaqësues te portit dhe vlerësime konkrete si më poshtë:

- Vlerësimi gjeoteknik;
- Monitorimi batimetrik;
- Kampionime biologjike dhe mjedisore e sedimenteve te fundit te detit,

në të gjithë zonën ku do te kryhet mirëmbajtja nëpërmjet thellimit (kanali hyrës / baseni), duke depërtuar ne te gjitha shtresat që janë objekt thellimi.



Kjo ftesë është në zbatim të ligjit Nr. 8990, Datë 23.01.2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" dhe të VKM Nr.994, Datë 02.07.2008 "Për tërheqjen e publikut në vendimarrje për mjedisin".

KOPJE NGA INTERNETI

Eduard Ndreu
Ing. Eduard NDREU
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

